

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME ORTAK TË VETËM**

**“OD-IS Energy & Technology” SHPK**

**NENI 1  
KRIJIMI I SHOQËRISË**

1. Sot më datë 26/10/2022 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “OD-IS Energy & Technology” shpk, (në vijim referuar si “Shoqëria”).
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.
3. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në aktet themeluese.

**NENI 2  
FORMA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhës nga dispozitat e këtij statuti dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, për aq kohë sa dispozitat e këtij statuti nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e mësipërm.

**NENI 3  
EMËRTIMI**

1. Emërtimi i shoqërisë është “OD-IS Energy & Technology” sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “sh.p.k”.

**NENI 4  
SELIA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga “Vaso Pasha” nr. 7, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një Vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

**NENI 5  
KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë e kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.



**NENI 6**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :
  - Hartimi, zhvillimi dhe zbatimi i projekteve në fushën e energjitikës;
  - Shërbime në fushën inxhinierike, të prokurimeve dhe ndërtimit;
  - Import-eksport, blerje dhe shitje me shumicë apo pakicë e aksesorëve e produkteve elektrike, materialeve të ndërtimit, impianteve energjitike, makinerive e pajisjeve elektrike dhe elektronike për përdorim industrial, etj.;
  - Qiramarrje dhe qiradhënie të makinerive dhe pajisjeve për qëllime të ndryshme;
  - Projektimi, ndërtimi, vënie në punë, administrimi, mirëmbajtja e impianteve apo veprave energjitike të cdo lloji.
2. Përveç aktiviteteve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtari tjetër që nga Ortaku do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për përmbushur objektin e Shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.

**NENI 7**  
**EMBLEMA, VULA**

1. Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Asambleja e Ortakut të Vetëm dhe nga Administratori i shoqërisë.
2. Forma dhe përmasa e vulës do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakut të Vetëm pas regjistrimit të saj, në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

**NENI 8**  
**KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lek. Kontributi i Ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Ortaku i Vetëm është zotëruar i një kuote në masën 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100.000 lekë, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

| Nr.           | Emri i Ortakut | Kuota | Vlera        | Përqindja % |
|---------------|----------------|-------|--------------|-------------|
| 1.            | Orkun Dogan    | 1     | 100.000 lekë | 100         |
| <b>TOTALI</b> |                | 1     | 100.000 lekë | 100         |

3. Kapitali i shoqërisë dhe ndarja e tij në kuota mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kapitali është shlyer tërësisht.



**NENI 9**  
**ORTAKU I VETËM DHE KUOTAT**

1. Shoqëria përbëhet nga një Ortak i Vetëm, me të dhënat e mëposhtme:
  - Orkun Dogan, shtetas turk, madhor me zotësi juridike dhe për të vepruar, lindur më 06/12/1976 në Ankara, banues në Stamboll, mbajtës i pasaportes me nr. U20269153, i cili zotëron 100 % të kuotave.
2. Ortaku i Vetëm i shoqërisë zotëron një kuotë në masën 100 % me vlerë 100.000 (njqind mijë) lek.

**NENI 10**  
**TE DREJTAT DHE DETYRAT E ASAMBLESË SË ORTAKUT TË VETËM**

1. Asambleja e Ortakut të Vetëm merr Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë. Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht, por pa u kufizuar, çështjet e mëposhtme :
  - a) Përcaktimin dhe mbikëqyrjen e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - b) Ndryshimet e statutit;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
  - d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
  - e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
  - f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - g) Riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e shoqërisë ;
  - h) Miratimin e strukturës së shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
  - i) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
  - j) Miratimin e marrjes së kredive bankare;
  - k) Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërishe;
  - l) Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë ;
  - m) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - n) Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar apo ky Statut.
2. Duhet regjistruar në veçanti ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, por pa u kufizuar në to, vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm për :
  - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
  - c) Investime;
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
  - e) Vendime të tjera që Asambleja e Ortakut të Vetëm vlerëson se duhen regjistruar.

**ADMINISTRATORI**

**NENI 11**  
**EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET**

1. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Ortakut të Vetëm merr vendim të posaçëm për rrimërimin e Administratorit pas periudhës së emërimit të parë.



2. Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, Administratori ka të drejtën të nënshkruajë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshirë hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë.
3. Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi nga Ortaku i Vetëm. Administratori i shoqërisë caktohet Orkun Dogan, shtetas turk, madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr. U20269153.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretet, personalisht ose me përfaqësim, tek palët e treta, institucione apo entitete publike;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) mbajë një regjister të veçantë ku të bëjë regjistrimin e të gjitha Vendimeve të Ortakut të Vetëm.
- e) mbajë korespondencë të rregullt me të tretët, si dhe të marrë të gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivën e shoqërisë;
- f) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,
- g) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në kete statut apo në kontratë;

## **NENI 12**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Akt Themelimi që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm sipas rregullave të përcaktuara, në përputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
3. Caktohet administratori i shoqërisë për regjistrimin fillestar të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**ORTAKU I VETËM**

**Orkun DOGAN**

